



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT SHKODER



Mr. 4047/ Prot
08.08.22

Nr. 502/1 prot.

Shkodër më 03.8.2022

LËNDA: Mbi vendimet nr. 45, 46 datë 27.07.2022 të Këshillit të Bashkisë Vau Dejës.

KËSHILLI BASHKIAK VAU I DEJËS

Prefekti i Qarkut Shkodër në zbatim të detyrave funksionale të ligjit nr. 107/2016 “Për Prefektin”, neni 8, shkronja “a”, kreu III, pika 11 e të Urdhërit të Kryeministrit nr. 50, datë 12.04.2017 “Për miratimin e detyrave të administratës së Prefektit të Qarkut”, neni 10/j i Urdhërit të MB nr. 175, datë 09.07.2020 “Për miratimin e rregullores së brëndshme “Për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut”, si dhe aneksin I “Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollin nga Prefekti i Qarkut”, të ligjit nr. 139/2015 “Për veteqeverisjen vendore”, i ndryshuar neni 24, të ligjit nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, neni 21, neni 28, pika 3, shqyrtoi vendimet nr. 45, 46 datë 27.07.2022 të Këshillit të Bashkisë Vau Dejës “Mbi pranimin e Znj. Dila Helmeza dhe Z. Dede Çuni në qendrën rezidenciale për të moshuarit “BESA” Barbullush”.

Prefekti ju sqaron se ky akt nuk përfshihet në kategorinë e akteve normative, për të cilat Prefekti në zbatim të nenit 8, shkronja “a” e ligjit 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” i ndryshuar ka detyrim të shprehet.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

PREFEKTI
Majlinda ANGONI
NË MUNGESË
SEKRETARI PËRGJITHSHËM
Felek KASEMI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VAU DEJËS
KESHILLI BASHKIAK**

VENDIM

Nr 46 . Date 27 / 07 /2022



Mbi Pranimin e të moshuarit Z.Dedë Çuni në Qendren e Përkujdesit Rezidencial për të Moshuarit "BESA", Barbullush

Mbështetur në ligjin 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", Bazuar ne ligjin nr.121/2016 "Per shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë; VKM-në 518, date 04.09.2018 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror, komunitar e rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzimet personale për përfituesit e shërbimit të organizuar "Kreu III Pika 13,A); pika 14; pika 17; pika 18; pika 23,a; pika 24; Kreu IV "Kriteret e përfitimit të shërbimit dhe përmbajtja e dosjes" pika 58,ç; pika 59;" me propozimin e Sektorit të Shërbimit Social, Kryetari i Bashkisë i propozon Këshillit Bashkiak të:

KESHILLI BASHKIAK :

VENDOSI

1-Pranimin e Z.Dedë Çuni me nr ID. F10801086B, në qendrën e përkujdesit rezidencial për të moshuar "Besa", Barbullush, duke i ofruar;

- Strehim
- Ushqim
- Përkujdesje Shëndetësore
- Përkujdesje Social-Psikologjike.

2- Ky vendim hyn në fuqi 10 dite mbas shpalljes publike, sipas përcaktimit të nenit 55, pika 6-të e ligjit 139/2015 datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" i ndryshuar.

3-Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Sektorit i Shërbimit Social.

SEKRETARI I KESHILLIT
Ardian ÇELEPIJA



KRYETARI I KESHILLIT
MARK BISHA

Miratuar me... 17vota

Vota pro 17

Vota kunder-

Vota Abstenim-

Zbardhur me date 02.08.2022